



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve

Nr. 8706/A Prot.

Tiranë, më 16.11. 2022

Lënda: Dërgohet Urdhëri i Ministrit nr. 268, datë 11.11.2022.

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku "Vasil Shanto" Tiranë

ALBPETROL SH.A. ✓

Patos

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 268, datë 11.11.2022 "Për disa ndryshime në Urdhërin e Ministrit nr. 169, datë 13.09.2022 "Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për bllokun "5" dhe bllokun "Velça".

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

prot. 8706

URDHËR

Nr. 268, datë 11.11 2022

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN E MINISTRIT NR. 169, DATË 13.09.2022
“FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARREVESHJEVE
HIDROKARBURE PËR BLOKUN “5” DHE BLOKUN “VELÇË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, dhe të “Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse” të miratuar me Urdhër Ministri nr. 246, datë 12.03.2018, për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për blloqet e Lira të Kërkimit, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

Ne Urdhërin e Ministrit nr. 169, date 13.09.2022 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2, ndryshon si më poshtë vijon:
“AKBN të publikojë menjëherë në faqen e saj të internetit hartën e bllokut “5” të kërkimit dhe Albpetrol Sh.a të publikojë menjëherë në faqen e saj të internetit hartën e bllokut të “Velçës” të kërkimit si dhe formularët përkatës të aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për bllokun “5” dhe bllokun “Velçës”, i cili duhet të jetë 90 ditë duke filluar nga data e njoftimit.
2. Pika 4, ndryshon si më poshtë vijon:

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Nr.1, 1001, Tiranë, Shqipëri, Faqja Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>

“Në zbatim të pikës 2, të “Rregullore për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, AKBN të përcjellë në MIE dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e tyre, bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure për bllok “për bllokun “5” të kërkimit, si dhe Albpetrol Sh.a të përcjellë në MIE dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure për bllok “për bllokun “Velçës” të kërkimit.

3. Pika 5, ndryshon si më poshtë vijon:

“Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen AKBN, Albpetrol Sh.a, si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në MIE”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Belinda Balluku





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 6786. Prot.

URDHËR

Nr. 169, datë 13.09 2022

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARREVESHJEVE
HIDROKARBURE PËR BLOKUN "5" DHE BLOKUN "VELÇË"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, dhe të "Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse" të miratuar me Urdhër Ministri nr. 246, datë 12.03.2018, për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për blloqet e Lira të Kërkimit, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. Njoftimin për të ftuar subjektet e interesuara për pjesëmarrjen me anë të aplikimeve, për të lidhur marrëveshje hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun "5" dhe bllokun "Velçë" të kërkimit.
2. AKBN të publikojë menjëherë në faqen e saj të internetit hartën e bllokut "5" dhe bllokut të "Velçës" të kërkimit si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për bllokun "5" dhe bllokun "Velçë", i cili duhet të jetë 90 ditë duke filluar nga data e njoftimit.

3. Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MIE dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.
4. Në zbatim të pikës 2, të “Rregullore për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, AKBN të përcjellë në MIE dokumentacionin e shoqërive aplikuese dhe vlerësimin e tyre bazuar në kapacitetin teknik, financiar si dhe termat dhe kushtet kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure për secilin bllok.
5. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen AKBN, si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në MIE.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

DHE

MINISTËR

Behinda Balluku

